



Pranuar / Dorezuar Prijmehet/Prodato Received/Delivery	18.01.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHICK	486/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1134/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen juridike "masë disiplinore", sipas ankesës me numër A.nr.1134/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 17.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1134/2022 e datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Vendimi i datës 01.12.2022 i Zëvendësuesit të Kryeinspektorit të Minierave në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" ndaj ankuesit.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli

7832/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 01.12.2022 të Zëvendësuesit të Kryeinspektorit të Minerave në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale lidhur me shqiptimin e masës disiplinore " Vërejtje me shkrim", për shkak shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (tutje referuar KPMM) ndërsa ky i fundit më datë 22.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 7832/2022 të datës 09.12.2022, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësimin e palës ankuese; kopje e Dokument identifikimit të ankuesit; Vendimin me numër Ref: 001/KPMM i datës 03.12.2020, Vendimin me numër KD 002/2022 i datës 25.11.2022 i Komisionit Disiplinor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 24.11.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 21.01.2021 dhe 10.01.2022; Kopje thirrje telefonike në VIBER; vendimin e datës 01.12.2022 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore vërejtje me shkrim e datës 01.12.2022; e-mailin e datës 18.10.2022 nga për MINES INSPECTORATE; e-mailin e datës 18.11.2022 nga ankuesi për dhe dhe e-mailin e datës 08.11.2022 nga për dhe e-mailin e datës 08.11.2022, 07.11.2022, 26.10.2022 nga për Propozimin për Komisionin Disiplinor me numër protokoli 8700 i datës 26.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoli 8081/2022 e datës 14.12.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 8291/2022 e datës 22.12.2022; Akt Emërimit e datës 23.03.2012 për ankuesin; Vendimin me numër Ref:003/0-1/KPMM i datës 11.01.2022 për emërimin e Komisionit Disiplinor; e-mailin e datës 22.11.2022 nga për e-mailin e datës 21.11.2022 nga për Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 25.11.2022; e-mailin e datës 26.10.2022 nga e-mailin e datës 26.10.2022 nga e-mailin e datës 20.11.2022 nga për e-mailin e datës 18.11.2022 nga për e-mail e datës 07.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin e tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse,*

Nga administrimit i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, gjegjësisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit të datës 23.03.2012 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës *Inspektor i Minerave-Xehtari*. Zëvendësuesi i Kryeinspektorit të KPMM-së, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, më datë 26.10.2022 ka parashtruar kërkesë të Komisioni Disiplinor për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me supozimin së ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3. 1 dhe 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i KPMM-së më Vendimin me numër KD 002/2022 datë 25.11.2022 ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke e kthyer rastin në shqyrtim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 01.12.2022 ka nxjerrë Vendim për shqiptimin e masës disiplinore *"vërejtje me shkrim"*, për shkak të shkeljeve disiplinore *shkelje e rregullave të etikës dhe sjellje e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun*, me arsyetimin se ankuesi më datë 07.10.2022 ka bërë inspektimin masiv në ndërmarrjen N.P.P "NITI", Sh.p.k, ndërsa në këtë rast ka pasur sjellje jo korrekte me kontrolluesin e ASHNA.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se masa disiplinore vërejtje me shkrim, është shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, respektivisht nuk kam bërë asnjë sjellje të pa rregullt ndaj askujt por kam përfunduar punën sipas përshtimit të detyrave të punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, si dhe nenit 50 paragrafi 1 të njëjtit ligj me të cilin është përcaktuar se: *"1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.*

Duke u bazuar në dispozitat si me lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar së mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit nuk ka marrë parasysh të gjitha elementet për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të përgjegjësisë së ankuesit si dhe parimet për individualizmin e masës disiplinore, sepse sipas aktit të kundërshtuar me ankesë dhe shkresave të lëndës nuk është konfirmuar fakti së nga veprimi i ankuesit të jetë shkaktuar ndonjë pasojë apo dëm për institucionin e KPMM-së apo ASHNA-së, dhe se përjashtimisht shkresës së datës 17.10.2022, me asnjë dëshmi nuk është vërtetuar së lidhur me ankuesin gjegjësisht komunikimin dhe sjelljen e ankuesit të jetë parashtruar me parë ndonje vërejtje apo pakënaqësi nga ana e zyrtarëve të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Civil.

Po nga vlerësimi i shkresave të lëndës rrjedhe së ankuesi nuk ka në fuqi ndonjë vërejtje apo masë tjetër disiplinore dhe së i njëjti lidhur me rezultatet në punë për vitin 2020 dhe 2021 është vlerësuar nga Zëvendësuesi i Kryeinspektorit të KPMM-së në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me notë (4) -"shumë mirë", përkatësisht referuar formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021 është konstatuar së ankuesi në fushën e komunikimit dhe përfaqësimit është vlerësuar po me notë katër (4)-shumë mirë.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, konstaton së një akt administrativ i nxjerr në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, Kolegji vendosi që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa anulohet Vendimi i datës 01.12.2022 i Zëvendësuesit të Kryeinspektorit të KPMM-së lidhur me shqiptimin e masës disiplinore “ vërejtje me shkrim” ndaj ankuesit.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.134/2022.

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokaturës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

